

# Statistikat vjetore të krimeve, 2018

**Tiranë, më 30 Prill 2019:** Në këtë publikim, statistikat e krimeve japin informacion mbi veprat penale, të dëmtuarit, personat e dyshuar si autorë në kryerjen e një vepre penale, procedimet penale, persona të pandehur dhe të dhëna mbi të burgosurit.


## Vepra penale

Në vitin 2018, janë evidentuar gjithsej 34.468 vepra penale, 0,4 % më shumë, krahasuar me vitin 2017. Në 2018, në raport me popullsinë, janë evidentuar 120 vepra penale për 10 mijë banorë, nga 119,4 që ishin në vitin 2017.

**Tab. 1 Vepra penale të evidentuara**

Veprat penale	2015	2016	2017	2018
Vrasje me dashje	54	71	50	51
Vrasje të mbetura në tentativë	138	132	129	114
Krime me dashje kundër shëndetit	2.892	2.579	2.650	2.493
Krime seksuale	149	120	113	110
Vjedhje banese	1.387	1216	1.145	1.218
Vjedhje automjetesh	277	298	329	252
Vjedhje lokale tregtie	719	572	492	596
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	150	81	118	70
Tentativë Vjedhje pasurie	417	413	417	383
Mashtrike	803	1.031	1.127	1.040
Fallsifikim monedhash	125	73	85	82
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.300	1.488	1.412	1.374
Krime në fushën e drogës	2.321	3.248	2.070	1.907
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.280	5.357	5.316	5.713
Tjetër	19.852	17.129	18.864	19.065
<b>Gjithsej</b>	<b>35.864</b>	<b>33.808</b>	<b>34.317</b>	<b>34.468</b>
<b>Për 10 mijë banorë</b>	<b>124,5</b>	<b>117,5</b>	<b>119,4</b>	<b>120</b>

Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2017 - 2018




**Autorë të veprave penale**

Në vitin 2018, janë regjistruar 39.649 autorë për vepër penale, 10,0 % më shumë, krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2018, meshkujt përbëjnë 92,9 % të autorëve për vepër penale.

Tab. 2 Autorë për vepër penale


Vepra penale	2015	2016	2017	2018
Vrasje me dashje	81	80	48	60
Vrasje të mbetura në tentativë	190	164	156	149
Krime me dashje kundër shëndetit	3.665	3.282	3.487	3.264
Krime seksuale	163	127	111	114
Vjedhje( neni 134)	807	824	629	3.178
Vjedhje me dhunë	131	123	157	115
Vjedhje me armë	474	354	381	23
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	164	88	130	77
Mashtrime	855	1.086	1.141	1.033
Fallsifikim monedhash	102	70	81	77
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.359	1.586	1.507	1.459
Krime në fushën e drogës	2.189	2.489	2.482	2.357
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.108	5.096	5.173	5.530
Tjetër	21.824	19.305	20.568	22.213
<b>Gjithsej</b>	<b>37.112</b>	<b>34.674</b>	<b>36.051</b>	<b>39.649</b>

**Fig. 2 Autorë gjithsej dhe autorë meshkuj për vepër penale**



Në vitin 2018, 31,3 % e autorëve janë të grupmoshës 30-44 vjeç, 29,5 % të grupmoshës 18-29 vjeç dhe 25,5 % i përkasin grupmoshës 45-59 vjeç.

**Fig. 3 Autorë për vepra penale sipas grupmoshave, 2018**



**Të Dëmtuar**


Në vitin 2018, janë regjistruar 19.101 persona të dëmtuar, 0,2 % më shumë, krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2018, të dëmtuarit për krime kundër personit përbëjnë rreth 36,7 % të totalit të personave të dëmtuar.

**Tab. 3 Të dëmtuar për krime kundër personit**

Të dëmtuar	2015	2016	2017	2018
Krime kundër jetës	1.768	1.673	1.606	1.652
Krime kundër shëndetit	3.334	2.990	3.220	2.965
Krime seksuale	146	121	114	105
Vepra penale kundër lirisë së personit	234	165	146	173
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	366	403	350	335
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.544	1.804	1.777	1.736
Të tjera kundër personit	50	40	44	41
<b>Të dëmtuar për krime kundër personit</b>	<b>7.442</b>	<b>7.196</b>	<b>7.257</b>	<b>7.007</b>
<b>Të dëmtuar gjithsej</b>	<b>20.168</b>	<b>19.078</b>	<b>19.062</b>	<b>19.101</b>

Në vitin 2018, në totalin e personave të dëmtuar për krime kundër personit, femrat përbëjnë 33,1 % të të dëmtuarve dhe përqindja më e madhe e tyre vihet re në krime seksuale, krime kundër moralit, dinjitetit si edhe krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.

**Fig. 4 Të dëmtuar për krime kundër personit sipas gjinisë, 2018**




**Procedime penale**

Në vitin 2018, numri i procedimeve penale të regjistruara është 31.389, 0,2 % më pak, krahasuar me vitin 2017. , Në vitin 2018, nga 29.329 procedime penale të përfunduara, 22,7 % e tyre janë pushuar, 37,1 % janë pezulluar dhe 40,2 % janë dërguar për gjykim në gjykatë.

**Tab. 4** Procedime penale të regjistruara

Veprat penale	2015	2016	2017	2018
Vrasje me dashje	141	167	120	126
Vrasje të mbetura në tentativë	49	51	43	52
Krime me dashje kundër shëndetit	822	738	862	908
Krime seksuale	130	109	102	113
Vjedhje (neni 134)	10.065	9.920	9.514	9.219
Vjedhja me dhunë	258	146	187	118
Vjedhja me armë	58	31	22	35
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	147	97	127	114
Mashtrime	1.071	1.401	1.060	872
Fallsifikim monedhash	133	94	78	80
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.206	1.355	1.310	1.209
Krime në fushën e drogës	2.033	2.795	1.764	1.524
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.659	3.681	3.639	4.121
Tjetër	12.680	10.698	12.634	12.898
<b>Gjithsej</b>	<b>32.452</b>	<b>31.283</b>	<b>31.462</b>	<b>31.389</b>

**Fig. 5** Progresi i procedimeve penale të përfunduara, 2015 - 2018



**Të pandehur**


Në vitin 2018, janë regjistruar 16.249 persona të pandehur, 0,7 % më pak, krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2018, të pandehurit e rritur përbëjnë 96,6 %, të miturit zënë 3,4 % në totalin e personave të pandehur.

**Tab. 5 Të pandehur për vepra penale**

Veprat penale	2015	2016	2017	2018
Vrasje me dashje	166	192	98	111
Vrasje të mbetura në tentativë	27	51	33	38
Krime me dashje kundër shëndetit	828	705	698	622
Krime seksuale	94	90	79	66
Vjedhje (neni 134)	1.937	1.690	1.376	1.299
Vjedhja me dhunë	144	94	87	73
Vjedhja me armë	41	27	17	13
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	114	88	78	68
Mashtrime	581	696	827	446
Falsifikim monedhash	38	53	41	45
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.222	1.281	1.194	1.198
Krime në fushën e drogës	1.199	1.693	1.819	1.183
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.405	3.186	3.034	3.596
Tjetër	9.925	7.600	6.975	7.491
<b>Gjithsej</b>	<b>19.721</b>	<b>17.446</b>	<b>16.356</b>	<b>16.249</b>

Në vitin 2018, meshkuj përbëjnë rreth 94,1 % në totalin të personave të pandehur.

**Fig. 6 Persona të pandehur sipas gjinisë**



### Të burgosur


Në 2018, numri i të burgosurve është 5.316, 2,0 % më pak, krahasuar me vitin 2017. Në raport me popullsinë, në 2018 janë 22 të burgosur për 10 mijë banorë, nga 17,9 të burgosur që ishin një vit më parë. Meshkujt përbëjnë 97,9 % të totalit të të burgosurve.

**Tab. 7 Të burgosur sipas veprave penale, 2015 – 2018**

Vepra penale	2015	2016	2017	2018
Vjedhje	1.212	956	1.049	859
Vrasje	1.470	961	994	1.053
Plagosje	218	100	103	94
Marrëdhënie seksuale me dhunë	134	83	90	108
Krime në fushën e drogës	1.329	1.530	1.598	1.706
Organizata kriminale	28	22	26	52
Mashtrim	68	53	99	112
Shfrytëzim prostitucioni	79	58	90	78
Të tjera	1.395	2.183	1.369	1.254
<b>Gjithsej</b>	<b>5.933</b>	<b>5.946</b>	<b>5.418</b>	<b>5.316</b>

Grupmosha 21-29 ka normën më të lartë të të burgosurve, në raport me popullsinë. Personat mbi 60 vjeç dhe nën 20 vjeç kanë normën më e ulët e të burgosurëve.

**Fig. 7 Të burgosur për 10 mijë banorë sipas grupmoshës**



# Metodologjia

## 1. Veprat penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

### Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

## 2. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

## 3. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara është vendimarrja e prokurorit në rastet kur nuk njihet autorëi i veprë penale ose kur i pandehuri vaun nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.

## 4. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.



## 5. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave të cilët ndodhen në burgje, të cilët kanë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

### Përkufizime

**Vrasje me dashje:** Vepër i kundraligjshëm, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përshihen veprat penale si: Neni 76 vrasje me dashje, Neni 77 vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 vrasje me paramendim, Neni 78/a vrasje për gjakmarrje, Neni 79 vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c vrasje për shkak të mardhënieve familjare, Neni 81 vrasje e foshnjës.

**Krime seksuale:** Përfshihen Nenet 100-108/a të Kodit Penal.

**Krime me dashje kundër shëndetit:** përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

**Mashtrim:** Përfshihen Nenet 143-149/b të Kodit Penal.

**Fallsifikim monedhash:** përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

**Krime në fushën e drogës:** Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

**Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor:** përfshihet veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.

### *Burimi i të dhënave:*

Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.